



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVË	
KOMUNA KLINA MUNICIPALITY OF KLINA	
01	Nr.No.Br. 030-34533/24
Data-Date-Datum 16.10.2024	
Klinë-Klina	



Memorandum Mirëkuptimi (MM)

MM numër: [2024-7]

Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar dhe lidhet ndërmjet kompanisë Associates in Rural Development, ARD INC - Dega në Kosovë (Tetra Tech, ARD), përgjegjës për implementimin e Projektit të USAID Adapt Activity në Kosovë, përfaqësuar nga Ben Toric, menaxher i projektit,

dhe

Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejmë Klina), përfaqësuar nga Zenun Elezaj, kryetar.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit paraqet kushtet dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira si dhe rregullon rolet, përgjegjësitë, detyrat dhe detyrimet e palëve. Megjithatë, ky MiM nuk është dokument me implikime ligjore, prandaj, do të shërbejë për arritjen e synimeve të përbashkëta, në bazë të mirëbesimit dhe vullnetit të mirë.

A. PALËT

Pala I – Associates in Rural Development, INC – Dega në Kosovë (Tetra Tech ARD), Partner implementues i projektit të USAID Kosovo Adapt Activity me lokacion në adresën "Ivy Residence", katër parë, Aktash, Prishtinë 10 000, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Ben Toric, menaxher i Projektit.

Misioni i Projektit të USAID Kosovo Adapt Activity është të kontribuojë në krijimin e reformës ligjore të qëndrueshme në fushën e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike si dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe kërkesës për iniciativa të mençura për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin publik dhe atë privat. Projekti synon të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve në Republikën e Kosovës për adaptimin dhe zbatimin e politikave dhe teknologjive që mbështesin zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe adaptimin ndaj tyre, duke mundësuar nxitjen për një mjeshtë rezilient dhe qëndrueshmëri ekonomike.

dhe

Pala II – Klina është një komunë në Republikën e Kosovës, me lokacion në rr. "Abedin Rexha" nr. 31, 32000, e përfaqësuar nga kryetari Zenun Elezaj. Me pozitë gjeografike në regionin e Pejës, në veriperëndim të Kosovës. Me të dhënat nga regjistrimi i popullësisë nga viti 2011, qyteti i Klinës kishte 5,542 banorë, ndërsa 38,496 në komunë. Në shtrirjen territoriale të komunës, bëhet bashkimi i lumenit Klina dhe Drini i Bardhë, me Ujëvarat e Mirushës që shërbejnë si një simbol i dukshëm i kësaj zone.

Misioni parësor i komunës është të promovojë eficiencën dhe të ndërtojë besimin ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve duke nxitur një marrëdhënie të fortë dhe bashkëpunuese – që është qelësi i qeverisjes demokratike. Kjo përfshin sigurimin e transparencës dhe ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë.

B. OBJEKTIVI

Palët nënshkruese të këtij MiM janë dakorduar që të bashkëpunojnë për të arritur synimin e përbashkët për ndërmarrjen e Studimit të Fizibilitetit për Menaxhimin e Rrezikut nga Vëرشimet dhe Adaptimin me Ndryshimet Klimatike. Ky studim do t'ia mundësojë komunës së Klinës t'i identifikojë strategjitetë e mundshme për menaxhimin e vërshimeve, të shqyrtojë alternativat e mundëshme dhe të implementueshme dhe t'i implementojej ato.

C. HISTORIKU

Komuna e Klinës përballet me rrezik të madh nga vërshimet për shkak se në territorin e saj kryqëzohen gjashtë lumenj. Vitet e fundit kanë nxjerrë në pah efektet e ndryshimeve klimatike, me përblytjet që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme socio-ekonomike dhe mjedisore. Kjo nënizon nevojën urgjente për masa efektive për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet për t'i mbrojtur qytetarët e Klinës. Qëllimi i studimit të fizibilitetit është të vlerësojë rrezikun aktual të përblytjeve dhe t'i orientojë investimet e nevojshme në parandalimin e përblytjeve, duke përfshirë zgjidhjet e bazuara në natyrë. Ky do të rrisë gatishmërinë e komunës për ndryshimet klimatike, reagimin ndaj emergjencave dhe mundësitë potenciale për zhvillimin ekonomik dhe turistik. Duke e ditur këtë nevojë, projekt i USAID, Kosovo Adapt Activity është i përkushtuar të bashkëpunojë me Komunën e Klinës për të krijuar një bazë për masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, siç identifikohen përmes studimit të fizibilitetit. Ky Memorandum i Mirëkuptimit (MiM) përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në mbështetjen e zhvillimit të këtij procesi.

D. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

D.1 ARD në këtë marrëveshje do të jetë përgjegjëse për:

- Ofrimin e mbështetjes teknike për komunën e Klinës për zhvillimin e studimit të fizibilitetit, përmes angazhimit të ekspertizës së jashtme.
- Zhvillimin e procesit të prokurimit për angazhimin e ekspertizës së jashtme për të realizuar studimin e fizibilitetit në emër të palëve të përfshira në këtë MiM, në koordinim me Komunën e Klinës.
- Koordinimin e komunikimit të rregullt me të gjitha palët e interesit, duke përfshirë kuvendin komunal, administratën komunale, komitetin komunal për siguri në bashkësi, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, OSHC-të lokale dhe të tjera.
- Ofrimin e mbështetjes për Komunën e Klinës për zhvillimin e proceseve, siç është formalizimi i formimit të grupit punues, ndërlidhur me studimin.
- Monitorimin e procesit nga aspekti teknik, duke zbatimin efikas të procesit si dhe efikasitet në dorëzimin e produktit final.
- Mbështetje për Komunën e Klinës në zhvillimin e kapaciteteve, përmes hartimit të kalendarit të aktiviteteve dhe shkëmbimit të përvojave me komunat tjera dhe palët e interesuara, përmes kolegjiumeve dhe grupeve punuese nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK).

D.2 Komuna e Klinës në këtë marrëveshje do të jetë përgjegjëse për:

- Pas nënshkrimit të këtij MiM të zyrtarizojë bashkëpunimin me ARD-në duke përbushur detyrimet, përfshirë edhe themelimin e një grupei punues dhe duke koordinuar komunikimin me palët përkatëse të interesit.
- Koordinimin e ngushtë me ekipin e projekti Adapt Activity për ta zbatuar planin e punës së grupit punues, duke siguruar përfundimin në kohë dhe efikas të detyrave.
- Të sigurojë që grupei punues ta mbështesë procesin e studimit të fizibilitetit.
- Të pranojë procesin e prokurimit të zhvilluar nga ARD/Projekti i USAID Kosovo Adapt Activity, duke përfshirë pjesëmarrjen në procesin e përgjedhjes.
- Të sigurojë që të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme për ta plotësuar kërkesën e bashkëfinancimit prej 10% të shumës totale ose 5,000 euro, cilado qoftë më e ulët, në përputhje me zotimet e Komunës së Klinës.
- Të zotohet për t'i përdorur gjetjet e studimit për sigurimin e financimit për zbatimin e zgjidhjeve më të realizueshme dhe efektive të menaxhimit të përmbytjeve dhe përshtatjes klimatike të identikuara në studim.
- Të jetë e gatshme që të ndajë me të tjerët përvojat nga ky proces, duke shfrytëzuar platformën e AKK-së të kolegjiumeve profesionale dhe grupeve punuese, si dhe ngjarjet e udhëhequra nga Projekti i USAID, Kosovo Adapt Activity.

Të dyja palët e kuptojnë dhe pajtohen se Tetra Tech ARD është partner implementues i USAID Kosovo Adapt Activity sipas udhëheqjes nga USAID. Zotimet në këtë MiM të ofruara nga Tetra Tech ARD mund të ndryshojnë në çdo kohë bazuar në udhëzimet e USAID-it dhe/ose disponueshmërinë e fondeve nga Projekti USAID Kosovo Adapt Activity.

E. KOHËZGJATJA

Palët do t'i përbushin përgjegjësitë përkatëse të dakorduara gjatë një periudhe nga **tatori 2024 deri në dhjetor 2025**, përveç nëse modifikohet ndryshe në përputhje me klauzolat I ose K më poshtë.

F. FINANCIMI DHE SHPENZIMET

Ky MiM nuk paraqet detyrim finansiar për Komunën e Klinës apo ndonjë punonjës të saj që punon me Projektin e USAID, Kosovo Adapt Activity. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe reciprokisht dhe në mënyrë eksplikite dhe është rënë dakord me shkrim, të gjitha shpenzimet dhe kostot e bëra nga secila Palë do të përballohen nga Pala që ka shkaktuar ato dhe asnjëra nuk do të jetë e detyruar të rimbursojë tjetrën. Në mënyrë të veçantë, pas përfundimit të procesit të prokurimit, të dyja palët në këtë MiM pajtohen që të paguajnë drejtpërdrejt operatorin e përgjedhur për pjesën e tyre të obligimit, e cila ndërlidhet me produktin si rezultat i këtij aktiviteti, ashtu siç përcaktohet në marrëveshjen e kontratës ndërmjet palës dhe ofruesit të përgjedhur të shërbimeve.

G. KOMUNIKIMI

Komunikimi i rregullt ndërlidhur me këtë MiM dhe çdo njoftim, kërkesë, dokument ose komunikim tjetër në lidhje me zbatimin e këtij MiM do të jetë me shkrim, në gjuhën angleze dhe do të konsiderohet i dhënë ose dërguar kur t'u dorëzohet Palëve në adresat në vijim: vjollca.behluli@tetratech.com nga Projekti i USAID Kosovo Adapt Activity dhe mirsad.dakaj@rks-gov.net nga Komuna e Klinës.

Të dyja palëve duhet t'u përmendet emri gjatë promovimit të aktiviteteve të propozuara në këtë Marrëveshje. Për aktivitetet promovuese publike, referenca duhet të jetë "Komuna e Klinës" si dhe ekskluzivisht "Projekti i USAID, Kosovo Adapt Activity" e jo "Tetra Tech" ose "ARD". Çdo material promovues do të duhet të miratohet nga Projekti i USAID, Kosovo Adapt Activity përpala se të shpërndahet.

H. KONFIDENCIALITETI

Secila Palë bie dakord të ruaj konfidencialitetin e çdo informacioni të marrë nga pala tjeter, duke përfshirë, por pa u kufizuar, të dhënat, raportet, planet teknike, planet e biznesit dhe çdo informacion financiar ose fiskal.

I. NDRYSHIMET

Ky MiM mund të ndryshohet ose modifikohet me shkrim me pëlgjim të ndërsjellë të të dyja palëve siç mund të jetë e nevojshme herë pas here. Pavarësisht nga ajo që u cek më sipër, ky MiM mund të modifikohet në mënyrë të njëanshme nga Tetra Tech ARD siç mund të kërkohet nga ndryshimet në financim ose fushëveprimin e punës së Projektit USAID Kosovo Adapt Activity.

J. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo dyshim ose paqartësi ose mosmarrëveshje, nëse ka, në interpretimin e dispozitave të këtij MiM ose ndonjë prej shtesave të tij, do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të ndërsjella ndërmjet Palëve.

K. SHKËPUTJA

Secila nga Palët, me shkrim, mund ta ndërpresë këtë MiM tërësisht ose pjesërisht përpala datës së skadimit, me njoftim 30 ditë përpala

L. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Palët që hyjnë në këtë MiM vazhdojnë t'i mbajnë misionet dhe mandatet e tyre të veçanta dhe unike, si dhe përgjegjësitë e tyre. Ky MiM nuk do të zëvendësojë ose ndërhyjë në asnjë mënyrë me marrëveshjet ose kontratat e tjera të lidhura ndërmjet palëve, qoftë para ose pas nënshkrimit të MiM-së, përvèç nëse përcaktohet ndryshe këtu.

Asgjë në këtë MiM nuk do të interpretohet se nënkupton njëren Palë si agjente të Palës tjetër për çfarëdo qëllimi dhe asnjëra nga Palët nuk do të ketë autoritetin ose kompetencën për ta detyruar Palën tjetër ose për të kontraktuar në emër të Palës tjetër ose për të krijuar një detyrim kundrejt Palës tjetër në çfarëdo mënyre.

Ky MiM dhe të gjitha njoftimet dhe ndryshimet në të do të ekzekutohen në gjuhën angleze, edhe pse mund të përkthehen në gjuhën shqipe. Versioni në gjuhën angleze do të konsiderohet i detyrueshëm dhe do të mbizotërojë në çfarëdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve.

M. PRANIMI DHE EKZEKUTIMI

Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar në ditën e vitit e përmendur më poshtë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Pranimi i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të konfirmohet nga të dyja palët me nënshkrim në rreshtat e mëposhtëm, si dhe përmes inicialeve në çdo faqe të kësaj marrëveshjeje. Palët pranojnë kushtet e kësaj marrëveshje.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët kanë nënshkuar këtë MM:

Për Associates in Rural Development, ARD INC – Për Komunën e Klinës
Dega në Kosovë

Emri: Ben Toric



Nënshkuar:

Data: 16.10.2024

Vendi: Klinë.

Emri: Zenun Elezaj



Nënshkuar:

Data: 16.10.2024

Vendi: KLINË